



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2018:011419  
Datë: 04.05.2018  
Numri i dokumentit: 00033385

**Pkr.nr. 7/2018**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti për Krime të Rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj kryetar, gjyqtarët Kymete Kicaj e Teuta Krusha - anëtarë, me pjesëmarrjen e sekretares juridike-procesmbajtëses Birsën Kume, duke vendosur në lëndën penale ndaj të akuzuarve B. D. nga K. Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KP dhe veprës penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, nga neni 372 par.2 lidhur me par. 1 të KP si dhe të akuzuarës A. V., nga fshati T.-K.-Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale moslajmërimi i veprave penale apo kryesëve të tyre nga neni 386 par.1 pika 1.8 dhe 1.9 të KP-së, sipas aktakuzës së ndryshuar Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.106/17 të datës 29.01.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarit B. D. dhe mbrojtësit të tij av. S. M., të akuzuarës A. V. dhe mbrojtësit të saj av.N. R., me datën 19.04.2018, murr dhe publikisht shpall këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**B. D.**, nga i ati A. dhe e ëma F., e vajzërisë D., i lindur me datën *data e lindjes...* në Kukës-Republika e Shqipërisë, ku edhe tani banon, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë.

**A. V.**, nga i ati H., dhe e ëma H., e lindur D., e lindur me datën *data e lindjes...* në fshatin T. –K. Republika e Shqipërisë ku edhe tani jeton, e martuar, ka të kryer shkollën e mes,e e gjendjes së mesme ekonomiek, me rofesion p arukiere, shqiptare shtetase e Republikës së Shqipërisë.

**I.**

Në mbështetje të nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPP-së.

## **LIROHET NGA AKUZA**

E akuzuara A. V.

Se me datë 30.06.2017 në periudhën kohore 18:40 minuta dhe 20:40 minuta në pikën kufitare të V. e akuzuara A. V. edhe pse ka qenë në dijeni për identitetin e të akuzuarit B. D. në kryerjen e veprave penale të përshkruara si në dispozitivin në I dhe II të aktakuzës nuk e lajmëron veprën penale zyrtarëve doganor si dhe policisë kufitare se në ulësen e prapme dhe në pjesën e poshtme të ulëses së saj i akuzuari B. D. ka vendosur bimën psikotropike e cila pas ekspertizues së kryer ka rezultuar si marihuanë në një sasi prej 2.715 gram dhe në një sasi të municionit-fishekëve prej 6857 fishekë të kal.7.62 mm.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre nga neni 386 par.1 nënparagrafi 1.8 të KPK.

- Për shkak se nuk është provuar që e akuzuara të ketë kryer këtë vepër penale.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## **II.**

Në kuptim të nenit 363 par. 1 pika 1.1

## **REFUZOHET AKUZA**

Ndaj të akuzuarës A. V.,

I.Se me datë 30.06.2017, në ora 20:40 min.në Pikën kufitare në V. pa autorizim ka transportuar substancën psikotropike e llojit marihuanë me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, në atë mënyrë që me rastin e hyrjes nga territori i Republikës së Shqipërisë, për në Republikën e Kosovës, me veturën e markës “Renault Scenik”, me ngjyrë hiri, me tabela të regjistrimit *numri i targës...*, të cilën e drejtonte i akuzuari i parë B. D., në veturë me të njejtin ka qenë edhe e akuzuara e dytë A. V., pasi ndahet për kontrollë nga zyrtari policor së bashku me doganierin, në momentin kur polici kishte kërkuar që ta hapë bagazhin dhe pyetet nga doganieri se a ka diçka për të deklaruar, ai ikë nga vendi i ngjarjes në drejtim të Republikës së Shqipërisë, ndërsa pas kontrollit të veturës nën ulësen nga prapa gjenden 4 (katër) qese të plastifikuara me substancë psikotropike në një sasi rreth 2 kg e 715 gr.

-Këso dore kishte për të kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KP.

II.Se me datën 30.06.2017 rreth orës 20:40 minuta në pikën kufitare në V. kanë transportuar armë në shkelje me Ligjin e zbatueshëm në lidhje me armët apo materiet plasëse, në atë mënyrë që me rastin e hyrjes nga territori i Republikës së Shqipërisë, për në Republikën e Kosovës me automjetin e markës “Renault Scenik” me ngjyrë hiri, me tabela të regjistrimit *numri i targës...*, të cilën e drejtonte i akuzuari i parë B. D., në veturë me të njejtin ka qenë

edhe e akuzuara e dytë A. V., dhe pas një kontrolli të zyrtarit policor të automjetit i cili kishte kërkuar që ta hap bagazhin duke e pyetur nga doganieri se a ka diçka për të deklaruar, ai ikë nga vendi i ngjarjes në drejtim të Republikës së Shqipërisë, ndërsa pas kontrollit të veturës nën ulëset e para tek vozitësi dhe pasagjereri në një bukër të krijuar enkas për fshehjen e municionit, gjendet sasia e municionit dhe ate 6.857 fishekë, të kalibrit 7.62 mm (të paketuara në 72 kuti x 20 copë, 32 x 70 copë dhe refuz.fishekë 3.177).

-Këso dore kishte për të kryer veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, nga neni 372 par.2 lidhur me par. 1 të KP.

Për shkak se Prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza.

### III.

#### ËSHTË FAJTORË

I akuzuari B. D.

I.Se me datë 30.06.2017, në ora 20:40 min.në Pikën kufitare në V. pa autorizim ka transportuar substancën psikotropike e llojit marihuanë me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, në atë mënyrë që me rastin e hyrjes nga territori i Republikës së Shqipërisë, për në Republikën e Kosovës, me veturën e markës “Renault Scenik”, me ngjyrë hiri, me tabela të regjistrimit *numri i targës...*, të cilën e drejtonte i akuzuari i parë B. D., pasi ndalet për kontrollë nga zyrtari policor së bashku me doganierin, në momentin kur polici kishte kërkuar që ta hapë bagazhin dhe pyetet nga doganieri se a ka diçka për të deklaruar, ai ikë nga vendi i ngjarjes në drejtim të Republikës së Shqipërisë, ndërsa pas kontrollit të veturës nën ulësen nga prapa gjenden 4 (katër) qese të plastifikuara me substancë psikotropike në një sasi rreth 2 kg e 715 gr.

-Këso dore ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KP.

II.Se me datën 30.06.2017 rreth orës 20:40 minuta në pikën kufitare në V. kanë transportuar armë në shkelje me Ligjin e zbatueshëm në lidhje me armët apo materiet plasëse, në atë mënyrë që me rastin e hyrjes nga territori i Republikës së Shqipërisë, për në Republikën e Kosovës me automjetin e markës “Renault Scenik” me ngjyrë hiri, me tabela të regjistrimit *numri i targës...*, të cilën e drejtonte i akuzuari i parë B. D., pas një kontrolli të zyrtarit policor të automjetit i cili kishte kërkuar që ta hap bagazhin duke e pyetur nga doganieri se a ka diçka për të deklaruar, ai ikë nga vendi i ngjarjes në drejtim të Republikës së Shqipërisë, ndërsa pas kontrollit të veturës nën ulëset e para tek vozitësi dhe pasagjereri në një bukër të krijuar enkas për fshehjen e municionit, gjendet sasia e municionit dhe ate 6.857 fishekë, të kalibrit 7.62 mm (të paketuara në 72 kuti x 20 copë, 32 x 70 copë dhe refuz.fishekë 3.177).

-Këso dore ka kryer veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, nga neni 372 par.2 lidhur me par. 1 të KP.

Gjykata në kuptim të dispozitave së lartshënuara dhe neneve: 4, 7, 41, 42, 43, 45, 46, 73 dhe nenit 273 par.2 të KP dhe nenit 372 par.2 -1 të KP-së të akuzuarin e:

## G J Y K O N

Për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KP ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 ( dy) viteve dhe dënimin me gjobë në lartësi prej 3.000 (tremijë) euro,

Për veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, nga neni 372 par.2 lidhur me par. 1 të KP ti shqiptohet denimi me burgim në kohëzgjatje prej 1. (një) viti dhe denimi me gjobë në lartësi prej 3000 (tremijë) euro.

Në kuptim të nenit 80 të KP-së të akuzuarit B. D. i shqiptohet denimi Unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 8 (tetë) muaj në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 16.01.2018 dhe denimi me gjobë në lartësi prej 6.000 euro të cilën gjobë i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, apo nuk mund ta paguajë, denimi me gjobë do ti zëvendsohet me denim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do ti caktohet 1 (një) ditë burgim.

Në kuptim të nenit 273 par. 5 të KP Konfiskohet Substanca psikotropike në sasi 2 kg e 715 gr dhe Vetura e markës “Renault Scenic”, me ngjyrë hiri, me tabela të regjistrimit *numri i targës...*

Në kuptim të nenit 372 par. 4 të KP konfiskohet Sasia e municionit prej 6.857 fishekë, të kalibrit 7.62 mm (të paketuara në 72 kuti x 20 copë, 32 x 70 copë dhe refuz.fishekë 3.177)

Për të akuzuarën A. V. shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve bugetore.

Obligohet i akuzuari B. D. që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj paushallin në lartësi secili prej nga 300 (treqind) euro, si dhe në emër të viktimave të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcnimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur akuzë PP/L.nr.106/17 të datës 29.01.2018, kundër të akuzuarve B. D., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KP dhe veprës penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, nga neni 372 par.2 lidhur me par. 1 të KP si dhe të akuzuarës A. V., nga fshati T.-K.-Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale moslajmërimi i veprave penale apo kryesëve të tyre nga neni 386 par.1 pika 1.8 dhe 1.9 të KP-së.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se duke marr për bazë gjatë shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave, ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarës A. V. të ketë ekzistuar qëllimi i transportit të substancave psikotropike dhe i trafikimit të tyre me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, si dhe të importit të municionit në sasi të përshkruar si në dispozitiv të akuzës, prokuroria e shtetit duke marr për bazë gjendjen e provave të cilat janë administruar sot dhe pas administrimit të tyre ka ardh në përfundim se veprat penale ndaj A. V. duhet të ricilësohen dhe tani duhet të figurojë se në veprimet e të akuzuarës figurojnë elementet e veprës penale moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre nga neni 386 par.1 nënpar.1.8 të KPK.

Se me datë 30.06.17 në periudhën kohore 18,40 minuta dhe 20 e 40 min, në pikën kufitare të V. e akuzuara A. V. edhe pse ka qenë në dijeni për identitetin e të akuzuarit B. D. në kryerjen e veprave penale të përshkruara si në dispozitivin I dhe II të aktakuzës nuk e lajmron veprën penale zyrtarëve do ganor si dhe policisë kufitare se në ulësen e prapme dhe në pjesën e poshtme të ulëses së saj i akuzuari B. D. ka vendosur bimën psikotropike e cila pas ekspertizës së kryer ka rezultuar si marihuanë në një sasi prej 2.715 gram dhe në një sasi të municionit-fishekëve prej 6857 fishekë të kal.7.62 mm. Me këtë e akuzuara A. V. ka kryer veprën penale moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre nga neni 386 par.1 nënpar.1.8 të KPK. Deri te kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe sot pas administrimit të provës, të foto dokumentacionit të Njësisë së forenzikës ku shihet se municioni dhe marihuana kanë qenë të vendosura nën ulësen e A. V. si dhe në pjesën e pasme të ulëses së automjetit “Renault senink” të cilën ka drejtuar këtu i akuzuari B. D.. E akuzuara A. V. vet ka thirr me telefon B. D. si dhe janë marr vesh edhe më herët, andaj e njëjta edhe pse ka mujt me vazhdu me autoubus në relacionin T.-P., dhe të shkon në hotelin që ka pas për destinacion, ajo është ndalur edhe me kërkesë të akuzuarit B. D. në K. dhe qëllimi i saj ka qenë që të krijoj lehtësira në pamje para organeve kufitare të policisë dhe doganës si të ishin në një bashkëjetesë, krejt me qëllim që të mundësohet ky kalim i kufirit me këtë sasi të marihuanës dhe fishekëve. E akuzuara A. V. ka vërejtur se automjeti është i stërngarkuar me bimë psikotropike por ka mujt të vërej edhe nga zhurma e fishekëve të cilët kanë qenë të vendosura në najlone, po ashtu edhe nga aroma e marihuanës të sasisë 2.715 gram në një hapësirë të vogël të automjetit, andaj teza e saj dhe mbrojtja se nuk e ka ditur se në automjet gjegjësisht në ulësen e saj është vendosur sasia e marihuanës dhe e fishekëve si dhe prapa në ulësen e automjetit nuk mund të qëndrojë.

Konsideron se në veprimet e saj formohen të gjitha elementet e veprës penale moslajmërimi i veprave p enale apo kryerësve të tyre nga neni 386 par.1 nënpar.1.8 , në këtë drejtim prokuroria e shtetit heq dorë nga akuza për pjesën ku A. V. është e akuzuar si bashkëryerë në dispozitivin I dhe II të aktakuzës pasi që një gjë të tillë nuk kemi m ujt të vërtetojmë gjatë shqyrtimit kryesor.

Në pjesën tjetër në tërësi ka mbetur- pranë akuzës për të akuz.B. D., me që me vet pranimin e tij se ditën kritike ka transportuar substancë psikotropike e cila pas ekspertizës është vërtetuar se është marihuanë si dhe sasinë e fishekëve e cila është mbështetur në provat tjera si foto dokumentacioni dhe konfiskimi i tyre, pa mëdyshje nga deklarata e tij është vërtetuar se qëllimi i tij ka qenë përfitimi material. Andaj kërkojm nga gjykata që të akuzuarin B. D. të shpall fajtorë për veprën penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope e analoge nga neni 273 par. 2 të KP si dhe për veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 të KPK, ndërsa të akuzuarën A. V. të shpall fajtorë për veprën penale moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre nga neni 386 par.1 nënpar.1.8 të KPK. Me rastin e marrjes së shqiptimit të

dënimit gjykata të ketë parasysh të gjitha rrethanat të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. në veçanti të ketë parasysh shkallën e rrezikshmërisë së veprave penale që janë bërë si dukuri në vendkalimin kufitare të V. si dhe rrezikimit të vlerave të cilët duhet të mbrohen e që në shumicën e rasteve me pasojat e këtyre veprave penale ballafaqohen të rinjtë dhe përdorimit të armëve ku vjen edhe deri te humbja e jetës qoftë nga konsumimi i narkotikëve ose plagosjet që ndodhin gjatë shitjes së municionit.

Si dënim plotësues kërkojm nga gjykata që të konfiskohet sasia e narkotikut 2 kg. e 715 gr. si dhe municioni i fishekëve prej 6.857 fishekë të kal.7.62 mm të paketuara në 72 kuti nga 20 copë si dhe 32 x 70 copë, si dhe të konfiskohet automjeti i markës “Reno senig “ ngjyrë hiri me tab. *numri i targës...* si mjet me të cilën është kryer vepra penale. Në fund të fjalës së tij përfundimtare deklaroi se prokuroria e shtetit në tërësi mbetet pranë aktakuzës së ndryshuar dhe ricilësuar për veprat penale ndaj të akuzuarit B. D. dhe A. V., me qëllim që gjatë shqyrtimit kryesor pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari B. D. dhe administrimit të provave gjatë shqyrtimit kryesor si kundër është ekspertiza laboratorit, për bimën psikotropike të llojit marihuan në një sasi prej 2 kg. e 750 gram si dhe 6857 fishekëve të kal.7.62 mm që janë gjetur të vendosura në automjetin “REno sening” të cilën e ka drejtuar B. D. në ulsen e përparme dhe të prapme si dhe pas deklaratës së të akuzuarit B. D. se qëllimi ka qenë shitja e tyre dhe përfitimi material nga ajo shitje ka rezultuar se në veprimet e B. D. formohen elementet e veprës penale të përshkruar, si dhe pas ndryshimit të akuzës për të akuzuarin A. V. dhe administrimit të provave në tërësi është vërtetuar se në veprimet e A. V. formohen elementi i veprës penale moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve nga neni 386 par.1 nënpar. 1.8 dhe 1.9 të KPK gjykata mbrojtjes së të akuzuarit nuk duhet të jep besueshmëri me qëllim që akuzuara A. V. ka qenë në dijeni dhe qëllimisht është ndalur në K. për të mundur një kalim sa më lehtë të kufirit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe se paraprakisht një në atë më herët edhe me telefon janë dëgjuar si dhe janë takuar me B. D., po ashtu ditën kritike janë dëgjuar me telefon dhe diku në K. janë takuar, A. V. nën ulësen e saj në pjesën e poshtme ka pas të vendosur një sasi të marihuanës dhe të fishekëve, e njëjta ka mundur që në relacionin T.-P. të vazhdojë rrugën me auto bus aq më parë kur vet këtu i akuzuari B. D. ka deklaruar se rrugën për në P. nuk e ka njohur aq më pak nuk e ka ditur ku është aeroporti i P.. Po ashtu mbrojtjes se rruga me B. D. ka qenë me një kosto më të lirë për të akuzuarin A. V. gjykata kësaj pjese të deklaratës së mbrojtjes nuk duhet të jep besueshmëri, pra e njëjta ka pas njohuri dhe ka ditur për veprat penale e të akuzuarit B. D. të përshkruara si në dispozitiv I dhe II të akuzës dhe pavarësisht këtij fakti e akuzuara nuk ka lajmruar organet doganore ose policore me rastine kalimit të kufirit. Se ka pas njohuri qëndron edhe fakti e njëjta po të kishte pas qëllimin për të vazhduar deri në P. me B. D. kishte me lën takimin diku në territorin e Kosovës në fshatin e V. por jo në K..Andaj kërkojmë nga gjykata që të akuzuarit B. D. dhe A. V. për veprat penale të ricilësuar dhe të ndryshuar për A. V. ta shpalli fajtor dhe denojë sipas ligjit. Me rastrin e marrjes së shqiptimit të dënimit gjykata të ketë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në veçanti të ketë parasysh se veprat penale të trafikimit me narkotikë si dhe të armëve dhe fishekëve në pjesën kufitare të hyrjes nga Shqipëria për në Kosovë janë bërë si dukuri dhe se veprat të këtilla më së shumti ndikojnë dhe se nga ato vepra pëson brezi i ri pasi nga konsumimi i marihuanës në shumicën e rasteve të rinjtë pësojnë edhe me shëndet, po ashtu nga trafikimi me armë-municion ndikon në shëndetin drejtpërdrejtë të njerëzve të cilët nga fishekët e kontrabanduara pas përdorimit pësojnë dhe humbin jetët e tyre. Andaj edhe dënim për kryerës së veprave duhet me qenë proporcional me peshën e veprës penale. Sa i përket dënimit plotësues mbetet pranë propozimit.

Gjykata konstatoi se Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka ndryshuar aktakuzën sa i përket të akuzuarit A. V. ashtu që është tërhequr nga akuza për veprat penale blerja,

posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KP dhe veprës penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, nga neni 372 par.2 lidhur me par. 1 dhe nenin 31 të KP dhe të njëjtën e ka akuzuar për veprën penale moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre nga neni 386 par.1 nënparagrafi 1.8 të KPK. Për të akuzuarin B. D. ka bërë ricilsimin e veprave penale ashtu që të njëjtin e ka akuzuar për veprat e njëjta penale por jo në bashkëkryerje me të akuzuarën A. V.

Pas ndryshimit të aktakuzës për të akuzuarën A. V. si dhe ricilsimit juridik për të akuzuarin B. D. gjykata iu ka dhënë mundësinë të akuzuave që edhe një here të deklarohen rreth fajësisë. Pas deklarimit të akuzuarve për fajësinë I akuzuari B. D. e ka pranuar fajësinë për të dy veprat penale të ricilësuar nga prokurori ndëra e akuzuara A. V. nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që është akuzuar me aktakuzën e ndryshuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. D. av. S. M. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se pasi që është pranuar fajësia e të akuzuarit e duke pas parasysh këtë fakt dhe rrethanat tjera lehtësuese si dorëzimin vullnetarë para organe të të akuzuarit, gjendjen e tij ekonomike, se është mbajtës i familjes-baba i 3 fëmijëve me bashkëshorten dhe nënën, moshën e tij, pendimin e tij për kryerjen e këtyre veprave penale, andaj konform nenit 75 par.1 pika 3 i propozoj gjykatës që pas vlerësimit të të gjitha rrethanave lehtësuese t ia shqiptojë një dënim sa më të butë.

I akuzuari B. D. në fjalën e tij përfundimtare në tërësi është pajtuar me fjalët e mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarës A. V. av. N. R. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se meqenëse tani në këtë shqyrtim gjyqësor prokurori i shtetit ka ndryshuar aktakuzën sa i përket të mbrojturës sime A. V. duke larguar dy vepra penale siç është nga neni 273 dhe 372 të KPRK kemi para vetes një kohë prej afërsisht 9 muaj e 20 ditë që Prokurori i shtetit kuptoi se A. V. nuk ka kryer asnjërin nga këto vepra penale, por meqenëse Prokurori i shtetit A. i ngarkoi një vepër të re penale nga neni 386 i KPRK si moslajmërimi i veprës penale apo kryerësve të tyre Prokurori i shtetit e tha se gjendja faktike për këtë vepër penale u vërtetua sot në këtë shqyrtim gjyqësor. Konsiderohet është e padrejtë nga Prokurori i shtetit që kur ne tani procedojmë me shkresat e njëjta të lëndës po ashtu edhe me ligje të njëjta dhe të thirret në fakte për një vepër penale e të cilat fakte nuk mund ti argumentojë me asnjë dokument të vetëm. Prokurori i shtetit të gjitha pyetjet që ka parashtruar A. po ashtu edhe të bashkëakuzuarit të saj B. D. edhe pse ka marr përgjigjen për ato pyetje ai ka konsideruar pyetjet e tija si fakte të drejtpërdrejta, si për shembull ai thotë A. ka mundur ti kuptojë për kryerjen e veprës penale nga zhurma e fishekëve, nga aroma e marihuanës dhe po ashtu duke e ditur se nën ulësen e saj kishte të fshehur marihuanën, e që nga dy të akuzuarit Prokurori i shtetit ka marr përgjigje se marihuana dhe fishekët nuk janë parë me anë të syrit, nuk është dëgjuar ndonjë zhurmë dhe se nuk është ndier asnjë aromë. Pretendimet tjera se pse A. nuk ka udhëtuar me autobus e pse nuk është takuar në Kosovë e shumë e shumë të tjera konsideroj se fare nuk e kanë vendin në drejtësi. Meqenëse që nga fillimi i kësaj procedure penale Prokurori i shtetit ka kuptuar se A. nuk kishte të bënte asgjë nga këto vepra penale Prokurori i shtetit ka mbajtur si opsion shprehimisht nën xhep veprën penale moslajmërimi i veprës penale për Alida Vrajën dhe këtë e thotë tani vetëm sa për tu thënë dhe për tu arsyetuar kërkesat e vazhdueshme që A. të mbahet nën masën e paraburgimit e që tani e njëjta ka mbushur rreth 10 muaj. Prokuroria e shtetit në këtë procedurë me faktet dhe provat që ka propozuar sa i përket A. V. edhe tani për veprën e re penale nuk ka arritur që ta dëshmojë një dyshim sa do të arsyeshëm se ajo ka kryer veprën penal e hiq më pak dyshim të bazuar mirë e që në shqyrtimin gjyqësor nevojitet përtej dyshimit

të bazuar mirë. Po që se lidhur me këto supozime është k rrijuar ndonjë mëdyshje sa do e vogël duke ju referuar nenit 3 par.2 të KPPK më dyshjet duhet të interpretohen në favor të të pandehurit. Për më tutje neni 361 i KPPK thotë se gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe provat e procedura në shqyrtimin gjyqësor. Në shqyrtimet gjyqësore provat e o fruara nga prokuroria e shtetit e të cilat gjykata i ka administruar janë raporti i ekspertizës për forenzikës me numër si në shkresat e lëndës, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm dhe foto albumi me fotografi, e pas kësaj edhe dëgjimet e dy të akuzuarve, asnjëra nga këto të nderuar trup gjykues nuk përbën provë se A. V. ka kryer veprën penale me të cilën e ngarkon prokuroria, e neni 7 i KPPK thotë qartë se gjykata, Prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrojnë që saktësisht dhe tërësisht ti vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm. Andaj të nderuar trup gjykues duke u bazuar nga gjitha të lartëcekurat dhe gjithë procedurën e zhvilluar si në prokurori ashtu edhe në gjykatë dhe duke ju referuar të gjitha shkresat e kësaj lënde presim nga trupi gjykues i kësaj gjykate që aktakuzën e prokurorisë ndaj A. V. ta hudh si të pabazë dhe në vështrim të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të merret aktgjykim lirues dhe të njëjtës në kohën sa më të shkurtër ti ndërprehet masa e paraburgimit.

I akuzuari B. D. gjatë shqyrtimit gjyqësorë e ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë me aktakuzën e ndryshuar.

E akuzuara A. V. nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale moslajmërimi i veprave penale apo kryesëve të tyre nga neni 386 par.1 pika 1.8 dhe 1.9 të KP-së

Gjykata konstatoi se nga vetë pranimi i fajësisë nga i akuzuari B. D. në tërësi është vërtetuar se me datë 30.06.2017 në periudhën kohore 18:40 minuta dhe 20,00:40 minuta në pikën kufitare të V. e akuzuara A. V. edhe pse ka qenë në dijeni për identitetin e të akuzuarit B. D. në kryerjen e veprave penale të përshkuara si në dispozitivin në I dhe II të aktakuzës nuk e lajmëron veprën penale zyrtarëve doganor si dhe policisë kufitare se në ulësen e prapme dhe në pjesën e poshtme të ulëses së saj i akuzuari B. D. ka vendosur bimën psikotropike e cila pas ekspertizës së kryer ka rezultuar si marihuanë në një sasi prej 2.715 gram dhe në një sasi të municionit-fishekëve prej 6857 fishekë të kal.7.62 mm.

Në tërësi është vërtetuar se i akuzuari B. D. me datën 30.06.2017 rreth orës 20:40 minuta në pikën kufitare në V. kanë transportuar armë në shkelje me Ligjin e zbatueshëm në lidhje me armët apo materiet plasëse, në atë mënyrë që me rastin e hyrjes nga territori i Republikës së Shqipërisë, për në Republikën e Kosovës me automjetin e markës “Renault Scenik” me ngjyrë hiri, me tabela të regjistrimit *numri i targës...*, të cilën e drejtonte i akuzuari i parë B. D., në veturë me të njejtin ka qenë edhe e akuzuara e dytë A. V., dhe pas një kontrolli të zyrtarit policor të automjetit i cili kishte kërkuar që ta hap bagazhin duke e pyetur nga doganieri se a ka diçka për të deklaruar, ai ikë nga vendi i ngjarjes në drejtim të Republikës së Shqipërisë, ndërsa pas kontrollit të veturës nën ulëset e para tek vozitësi dhe pasagjereri në një bukker të krijuar enkas për fshehjen e municionit, gjendet sasia e municionit dhe ate 6.857 fishekë, të kalibrit 7.62 mm (të paketuara në 72 kuti x 20 copë, 32 x 70 copë dhe refuz.fishekë 3.177).

Pasi që e akuzuara A. V. nuk e ka pranuar fajësinë gjykata i ka administruar provat materiale dhe atë:

- Raportin e ekspertizës të Agjencionit të Kosovës për Forenzikë me nr.AKF/2017-2260/2017-2034 të datës 09.10.2017.



- Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me numër të rastit 2017 – YWV-043.
- Foto dokumentacioni i Njësiit të Forenzikës të armëve-municionit të konfiskuar dhe bimëve psikotrope të llojit marihuanë.

Nga Raporti i ekspertizës të Agjencionit të Kosovës për Forenzikë nr.AKF/2017-2260/2017-2034 të datës 09.10.2017 është vërtetuar se substanca psikotropike përmbanë kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC).

Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me numër të rastit 2017-YWV-043 është vërtetuar tek i dyshuari B. D. në veturën me targa *numri i targës...* janë gjetur 5 qese marihuanë me peshë 2.715 gram, ndërsa në vërtetimin e dytë me të njëjtin numër është dhënë konsatimi i njëjtë se në veturën *numri i targës...* e të dyshuarit –A. V. janë gjetur 5 qese marihuanë me peshë 2.715 gram.

Nga foto dokumentacioni i Njësiit të Forenzikës të armëve-municionit të konfiskuar dhe bimëve psikotrope të llojit marihuanë shihet vetura “Renault” me targa të regjistrimit *numri i targës...*, shihet që në pjesën e pasme nën ulësen e automjetit është vendosur narkotiku i llojit marihuanë si dhe gjithashtu shihet sasia e municionit-fishekët të cilat janë gjetur në veturën “Renault”.

E akuzuara A. V. në mbrojtjen e saj gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me B. D. janë njohur para 6-7 muajsh por mund të jetë edhe një vitë, përmes kumatës së saj Sh., arsyeja për të cilën jemi njohur është se unë dhe daja i B. i cili jeton në A., me të cilin do të bënim bashkëjetesë në mënyrë që ti rregullojë dokumentet për A.i, ku atë ditë kemi ngrënë një drekë së bashku dhe më që nga ajo ditë më nuk jam takuar me B. D. vetem se kemi biseduar në telefon për arsye Familjare dhe jo biseda tjera, ndërsa data 30.06.2017, ishte dita kur unë morra rrugën nga T. për në K. ku kishin lënë takim me B. D. lidhur me udhëtimin tim nga K.i për në Airoportin e Prishtinës, gjë për të cilën kemi biseduar në telefon me B. D. një ditë para udhëtimit, ku kemi lënë vendtakimin në K. për arsye se transporti me B. ishte më i lirë, ku destinacioni të cilin do të më dërgonte B. shte Hotel “Berati”, pranë Airoportit të Prishtinës, ku unë të nesërmen më datë 01.07.2017 do të udhëtoja për në Z. tek M. P., i cili njëherit kishte siguruar edhe biletën në Agjensionin Air Prishtina, ku fluturimi ishte në ora 10,10-15, por M. më tha se duhet të isha në Airoport në ora 8,00 në mënyrë që të bëja check in, unë nga T. jamë nisur me autobusin e ores 6,00 T.-K., gjatë rrugës i bëra telefonat B. e pyeta ku do më presësh dhe ai mu përgjigjë tek ura, ku dhe aty u takuam, hapa bagazhin dhe i futa koferrat, ku njëri ishte më i madh ndërsa tjetri më i vogël, në të cilat kisha futur teshat e mija personale sepse kisha për të udhëtuar, ndërsa unë jamë ulur në sediljen (ulësen e parë) afër shoferit, që nga momenti kur hapa bagazhin e veturës si dhe kur hipa në vetur nuk kam vërejtur se ka pasur ndonjë erë apo zhurmë jo të zakonshme, gjatë rrugës me B. kemi biseduar biseda familjare dhe jo për gjëra të tjera, unë B. i dhash 50,000 lekë, 20,000 lekë për naftë, ndërsa 30.000 lekë ti bënë në Euro, ku B. nuk i morri këto lekë më tha se rregullohem dhe se lekët në euro i bëjmë në P.

Duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarës A. V. gjykata ia fali besimin, ngase mbrojtja e sajë është bindëse the mjaft logjike e gjithashtu përputhet edhe me provat materiale. Nga mbrojtja e të akuzuarës është vërtetuar se e njëjta ditën kritike ishte nisur nga T. për të udhëtuar për në Aeroportin e Prishtinës, e duke qenë se autobusi ishte i linjës T.-K. e njëjta kishte kërkuar nga i akuzuari B. D. që ta dërgonte deri në P.. Atë ditë e akuzuara takohet me të akuzuarin B. D. i cili me veturën e Renault kishte dalë tek ura e K. që ta merr të akuzuarën A.

V., e njëjta i fut koferat në bagazhin e automjetit ulet në karrigen e pasagjerit dhe nisen për në P.. Në bagazhin e automjetit nuk kishte vërejtur asnjë send e gjithashtu edhe në ulësen e pasme skishte vërejtur asgjë. Këtë deklaratë gjykata e ka marrë si të besueshme pasi që edhe nga fotodokumentacioni i veturës nuk vërehen se në bagazhin e automjetit si dhe në ulëset e automjetit të jenë vërejtur substanca narkotike dhe fishekët-municioni i gjetur në veturën Renault Senic që e drejtonte i akuzuari B. D.

Në rastin konkret nuk është kontestuese se me datën 30.06.2017 e akuzuara A. V. ishte nisur nga T. me autobusin e linjës T.-K. për në k.. Në vendin tek ura e K. takohet me të akuzuarin B. D. i cili me veturën Renault Scenic kishte dalë që ta merrte të akuzuarën dhe ta dërgonte për në aeroportin e Prishtinës pasi që e njëjta kishte për të udhëtuar për në botën e jashtme. E akuzuara A. V. i fut koferat e saja në bagazhin e automjetit dhe ulet në ulësen e pasagjerit afër shoferit dhe nisen për në P., kur vijnë në kufirin Shqipëri-Kosovë pas një kontrolli që ia bëjnë zyrtarët policor kërkojnë që ta hap bagazhin duke e pyetur nga doganieri se a ka diçka për të deklaruar, i akuzuari B. D. ikë nga vendi i ngjarjes në drejtim të Republikës së Shqipërisë ndërsa e akuzuara A. V. mbetet në veturë, pas kontrollit të automjetit nën ulësen prapa gjenden 4 (katër) qese të plastifikuara me substancë psikotropike në një sasi rreth 2 kg e 715 gr, ndërsa nën ulëset e para tek vozitësi dhe pasagjereri në një bunker të krijuar enkas për fshehjen e municionit, gjendet sasia e municionit dhe ate 6.857 fishekë, të kalibrit 7.62 mm (të paketuara në 72 kuti x 20 copë, 32 x 70 copë dhe refuz.fishekë 3.177).

Pra në rastin konkret sipas aktakuzës sasia e narkotikut prej 4 (katër) qese të plastifikuara me substancë psikotropike në një sasi rreth 2 kg e 715 gr **është gjetur nën ulësen mbrapa**, ndërsa nën ulëset e para tek vozitësi dhe pasagjereri **në një bunker të krijuar enkas për fshehjen e municionit**, është gjetur sasia e municionit dhe ate 6.857 fishekë, të kalibrit 7.62 mm (të paketuara në 72 kuti x 20 copë, 32 x 70 copë dhe refuz.fishekë 3.177), pra sipas gjykatës nuk qëndron pretendimi i prokurorit të shtetit se e akuzuara e ka ditur për narkotikun dhe municionin i cili ka qenë i fshehur në veturë kjo për faktin se vendet ku kanë qenë të fshehura nuk janë vërejtur nga e njëjta ndërsa prova tjera se e njëjta e ka ditur një gjë të tillë nuk ka pasur. Gjithashtu nuk qëndron edhe pretendimi i prokurorit të dhënë në fjalën përfundimtare se e akuzuara ka vërejtur se automjeti është i stërngarkuar me bimë psikotropike por ka mujt të vërej edhe nga zhurma e fishekëve të cilët kanë qenë të vendosura në najlone, po ashtu edhe nga aroma e marihuanës, pretendim ky i pa bazuar dhe jo logjik pasi që edhe narkotiku edhe municioni kanë qenë të fshehur ashtu që nuk është vërejtur fare, ndërsa se a ka pasur zhurmë nga municioni apo se ka pasur aromë nga mariuhana me asnjë provë nuk është vërtetuar një pretendim i tillë, e gjithashtu se a ka mundur apo jo e akuzuara A. V. të ndogjoj zhurmën e municionit dhe të ndjen aromën e narkotikut këto gjykata nuk i ka pranuar si pretendime reale.

Nga të gjitha të lartpërmendurat sa i përket të akuzuarës A. V. gjykata konstatoi se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesorë me asnjë provë nuk është vërtetuar se e akuzuara ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë.

Sa i përket të akuzuarit B. D. gjykata konstatoi se i njëjti ka pranuar fajësinë, dhe se pranimi i fajësisë është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 të KPP, dhe se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij Av. S. M., pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes. Në këto rrethana gjykata konsideroi se në veprimet e të akuzuarit K. K. janë formuar të gjitha elementet e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 paragrafi 1 të KP-së.

Për të akuzuarin B. D. gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në neni 73 të KPK-së, të

cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata mori parasyshë pranimin e fajsesië nga i akuzuari gjithashtu faktin se i njëjti është person familjar baba i tre fëmijëve si dhe sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësorë. Andaj bazuar në këto rrethana e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht renduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykim, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KPK-së dhe ky dënim i tillë, i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari B. D.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u murr në mbështetje të nenit 454 par.1 dhe nenit 451 par.1 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
- Departamenti i Krimeve të Rënda-  
Pkr.nr.7/2018 me datë 19.04.2018

Procesmbajtësja,  
Birsen Kume

Kryetari i trupit gjykues,  
Skender Çoçaj

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.